



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.75/25

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Krenar Berisha kryetar, Faton Bajrami dhe Ramush Bardiqi, anëtarë, në konfliktin administrativ të paditësit/propozuesit Center Mall shpk me NUI 810832057, përfaqësuar me autorizim nga shoqëria e avokatëve Koci & Vokshi, në Prishtinë, kundër të paditurës Komuna e Gjakovës-Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave në Procedurën e Dhënies në Shfrytëzim të Pronës së Paluajtshme Komunale, me bazë juridike, anulim vendimi, me kërkesë për shtyrjen e ekzekutimit të njëjtit, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për çështje administrative, K.A.nr.547/24 të datës 29.11.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 22.01.2025, merr këtë:

A K T V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e paditësit Center Mall shpk me NUI 810832057, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për çështje administrative, K.A.nr.547/24 i datës 29.11.2024, Vërtetohet

A r s y e t i m i

Me Aktvendimin e ankimuar të Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për çështje administrative, është Refuzuar si e pabazuar kërkesa e paditësit Center Mall shpk me NUI 810832057, me të cilën ka kërkuar shtyrjen e ekzekutimit të vendimit 01nr.353/01-16037 datës 30.10.2024 i nxjerr nga i padituri

Komuna e Gjakovës-Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave në Procedurën e Dhënies në Shfrytëzim të Pronës së Paluajtshme Komunale.

Kundër këtij aktvendimi ka ushtruar ankesë përfaqësuesi i autorizuar i paditësit, me të cilën e ka kundërshtuar ligjshmërinë e të njëjtit, për shkak se ky vendim i shkallës së parë është i gabuar dhe në konstatimet e gabuara se kushtet për shtyrje të ekzekutimit nuk janë plotësuar, vlerësojmë se gjykata e shkallës së parë ka vendosur në mënyrë arbitrare me refuzimin e kërkesës për shtyrje të ekzekutimit të vendimit të kontestuar, ndërkaq kushtet kumulative për vendosjen e masës janë plotësuar. I propozon gjykatës së shkallës së dytë që të aprovohet ankesa si e bazuar, të anulohet aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për çështje administrative, K.A.nr.547/24, dhe Shtyhet ekzekutimi i vendimit 01nr.353/01-16037 datës 30.10.2024 i nxjerr nga i padituri Komuna e Gjakovës-Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave në Procedurën e Dhënies në Shfrytëzim të Pronës së Paluajtshme Komunale, deri në vendimin definitiv gjyqësor sipas padisë.

Në përgjigje ne ankesë, përfaqësuesja ligjore e të paditurës e konteston në tërsi ankesën e paditësit si të pabazuar, të paargumentuar, dhe i propozon gjykatës që ta refuzoj ankesën e paditësit dhe ta lë në fuqi aktvendimin e Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për çështje administrative, K.A.nr.547/24 datë 29.11.2024.

Dhomat e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale të Kosovës, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar, pretendimet ankimore, përgjigjen në ankesë, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 12 të Ligjit 08/L-015, dhe nenit 49 të LKA-së, ka gjetur se:

Ankesa është e pabazuar

Dhoma e shkallës së dytë, duke shqyrtuar shkresat e lëndës, aktvendimin e kundërshtuar sipas ankesës së paditësit, gjen se dhoma e shkallës së parë, pas shqyrtimit të propozimit të paditësit, për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit 01nr.353/01-16037 datës 30.10.2024 i nxjerr nga i padituri Komuna e Gjakovës-Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave, ka

Refuzuar kërkesën e paditësit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të paditurit, me arsyetimin se paditësi nuk ka pësuar ndonjë dëm nga vendimi i kundërshtuar sepse përkundër faktit se i njëjti është kualifikuar si ofertues me çmim më të lartë, procedura e përzgjedhjes i nënshtrohet verifikimit të plotësimin të kushteve të përcaktuara sipas rregullave dhe dispozitave ligjore për të garantuar një proces të drejt, të ligjshëm. Gjykata vlerësoi të pabazuara pretendimet se shtyrja e ekzekutimit këtij vendimi, e dëmton palën e paditur dhe nuk paraqet kundërshtim me interesin publik, sepse vlerëson se dhënia e në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme në pronësi të Komunës, në radhe të parë ka interesin e të paditurës si titullar i paluajtshmërisë dhe interesin publik. Prandaj gjykata vlerëson se nuk janë plotësuar kushtet ligjore për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ të kontestuar, nga neni 22 par.2 të LKA-së.

Dhoma e Shkallës së Dytë, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, pranon në tërësi si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e tillë të Dhomës së shkallës së parë, nga se edhe sipas vlerësimit të Kolegjit të kësaj gjykate, në rastin konkret nuk janë plotësuar në mënyrë kumulative kushtet për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ të paraparë në nenin 22 par.2 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Me këtë dispozitë juridike është paraparë që shtyrja mund të bëhet: nëse ekzekutimi i aktit administrativ do t'i sillte dëm paditësit, i cili vështirë do të riparohej, kurse shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, e as që shtyrja do ti sillte ndonjë dëm palës kundërshtare përkatësisht personit të interesuar.

Mbi këtë gjendje të fakteve, Kolegji gjen se Dhoma e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e refuzimit të kërkesës së paditësit, me të cilën ka kërkuar shtyrjen e ekzekutimit të vendimit 01nr.353/01-16037 datës 30.10.2024 i nxjerr nga i padituri Komuna e Gjakovës-Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave, deri në vendim përfundimtar gjyqësor, dhe se nuk është cenuar ligji në dëm të ankuesit, me rastin e refuzimit të propozimit për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ kontestues. Meqë në këtë rast propozuesi-paditësi, në ankesën e ushtruar nuk ka bërë të besueshme pretendimet e tij, se janë

plotësuar në mënyrë kumulative kushtet për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ, e me të cilin do të arsyetohej shtyrja e ekzekutimit të vendimit duke ju referuar dispozitave ligjore, të nenit 22 par.2 të LKA-së, prandaj, pretendimet ankimore të propozuesit/paditësit, se gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar në mënyrë të gabuar gjendjen faktike, se janë plotësuar në mënyrë komulative kushtet për aprovimin e një mase të tillë, se paditësit do ti shkactohej dëm i madh dhe vështirë i riparueshëm, Kolegji vlerësoi se këto pretendime nuk janë të bazuara në ligj dhe nuk mund të ndikojnë në një gjendje tjetër faktike që e ka konstatuar Dhoma e shkallës së parë.

Duke marrë parasysh se në rastin konkret kemi të bëjmë me një proces administrativ, që ka të bëjë gjithashtu edhe me interesin publik, Kolegji vlerësoi se pretendimet ankimore tani në këtë fazë të procedimit administrativ nga ankuesi-propozuesi i masës së sigurimit, nuk janë të mjaftueshme dhe bindëse për tu aprovuar ankesa dhe për tu aprovuar propozimi për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të atakuar deri në vendosjen sipas padisë së paditësit. Ngase edhe vlerësimi i Kolegjit është se nuk janë përmbushur kushtet ligjore për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të ankimuar, siç parashihet në nenin 22 par.2 të LKA-së.

Mbi këtë gjendje të fakteve, Kolegji gjen se Gjykata e Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për çështje administrative, në mënyrë të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e refuzimit të propozimit të paditësit, me të cilën ka kërkuar shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të paditurës.

Andaj, ankesa si e tillë refuzohet, ndërsa aktvendimi i ankimuar vërtetohet si i drejtë dhe i ligjshëm.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 12 të Ligjit 08/L-015, dhe nenit 49 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**

Dhomat e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II.nr.75/25 datë 22.01.2025

Kryetari i Kolegjit

Krenar Berisha